

VENDIM
Nr. 867, datë 27.12.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 769,
DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA LINDORE TIRANË,
LOTI III (SHTESA)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 769, datë 20.12.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 491 309 103 (katërqind e nëntëdhjetë e një milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 491 309 103 (katërqind e nëntëdhjetë e një milionë e treqind e nëntë mijë e njëqind e tre) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) 445 657 671 (katërqind e dyzet e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një) lekë përballohen nga llogaria e veçantë për shpronësimet, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

b) 45 651 432 (dyzet e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.”.

2. Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, bën ndarjen e pasurisë “arë” për sipërfaqen e shtuar, objekt shpronësimi, dhe sipërfaqen që mbetet.

IV. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 769, DATË 20.12.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA LINDORE TIRANË, LOTI III (SHITESA)’”

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM										SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Artë (m ²)	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	VLERA TOTALE (lek)	
	A	B	C	C	C	D	E	F	G	H	I	L	M	N	O	P	Q	Y			Z	
1	Vjollca	Hajdar	Alla	TITRANË	3976	155/50	ARË	1180	1180			334	448	149,632						149,632	Konfirmuar nga ASHK-ja	
	Avni	Hajdar	Qosja																			
	Myzejen	Hajdar	Miccolis																			
	Alime		Qosja																			
2	Sadik	Murat	Luga	TITRANË	8180	7/634	Truall	1500		1500					1,340	31,270	41,901,800			41,901,800	Konfirmuar nga ASHK	
	Adriana	Muhareem	Gega																		Konfirmuar nga ASHK-ja. Shpronësuar për truallin në VKM-në nr. 557, datë 27.5.2016	
3	Donald	Bexhet	Gega	TITRANË	8170	8/523	Truall	520		520	85						40	90,000	3,600,000	3,600,000		
Vlera totale																					45,651,432	